


REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR
TIRANE

Nr.5059 Akti

V E N D I M

“PËR SIGURIMIN E PADISË”

“I SHKURTUAR”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e përbërë prej:

GJYQTARE TEUTA HOXHA

Asistuar nga sekretare gjyqësore **Entela Dedja**, me datë 05 shkurt 2016 mori në shqyrtim çështjen civile nr. 5059 akti me palë:

Paditës Vjollca Hoxha; Lorela Hoxha ;Sara Hoxha; Redia Hoxha;Itan Hoxha

Të paditur Albert Sino
Aurel Baçi

OBJEKTI Njohje Pronar të paditësave edhe mbi 60% të kuotave të shoqërisë “Top Channel” Sha për shkak se kontrata e shitjes së aksioneve nr.1154 Rep dhe 598/2 kol datë 15.06.2007 e lidhur para noteri Artan Treska është absolutisht e pavlefshme, pasi është kryer në kundërshtim me ligjin.
Urdhërimin e Çregjistrimit nga regjistri i Aksionerëve të Shoqërisë “Top Channel” Sha të të paditurve.

Marrja e masës së sigurimit të padisë nëpërmjet pezullimit të ushtrimit të të drejtave që rrjedhin nga aksionet si dhe ndalimi i tjetërsimit të aksioneve nga të paditurit.

BAZA LIGJORE

Nenet 92 dhe 199 e vijues të K.Civil dhe 208 i K.Civil Kodi i Familjes; Ligji nr.9901 datë 14.04.2008.
Nenet 202 e 204, dhe 211 te Kodit të Procedurës Civile.

-Gjykata; si dëgjoi përfaqësuesin e palës paditëse Av. Envi Hicka që kërkoi marrjen e masës së sigurimit të padisë; procedoi në mungesë të të paditurve konform nenin 205 të K.Pr. Civile;

Në mbështetje te neneve 202, 205 dhe 206 të KPrC, gjykata;

V E N D O S I

- Pranimin e kërkesës
- Ndalimin e tjetërsimit të aksioneve të të paditurve Albert Sino dhe Aurel Baçi në shoqërinë “**Top Channel**” Sha dhe pezullimin e të drejtave që rrjedhin prej tyre deri në përfundim të këtij gjykimi.
- Pala paditëse detyrohet të depozitojë një garanci bankare në shumën 30.000.000 (tridhjetë million) lekë per llogari te ketij procesi me numer 5059 akti date 18.09.2016.
- Një kopje e këtij vendimi të dërgohet në QKR.
- Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim sipas ligjit në Gjykatën e Apelit Tiranë brenda afatit 5 ditor , afat që fillon nga e nesërmyja e shpalljes se vendimit .
- Tiranë më 05 shkurt 2016 .

SEKRETARE


Entela Dedja


Teuta HOXHA